

Agim Maliqi*

LOGARIDHËNIA E GJYQTARËVE NË DRITËN E LIGJIT PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE

Hyrje

Në këtë punim janë analizuar dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji nr.06/L-057)¹, i cili ka hyrë në fuqi nga 13.12.2018.

Është e rëndësishme të potencohet se vështrimi i këtyre dispozitave është i rëndësishëm për faktin se jo rrallë herë është debatuar për përgjegjësinë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre gjyqësore. Qëllimi i nxjerrjes së ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve është rritja e llogaridhënies dhe krijimi i instrumenteve efikase për disiplinimin e gjyqtarëve dhe është i ndërtuar mbi parimin e ligjshmërisë, respektimin e pavarësisë së gjyqësorit, gjykimin e drejtë, proporcionalitetin, transparencën dhe llogaridhënien, parime të cilat janë mjaft të rëndësishme për zhvillimin e procedurës së drejtë dhe objektive.

Punimi trajton përgjegjësitë dhe shkeljet e përcaktuara disiplinore për gjyqtar, për të vazhduar me masat disiplinore të përcaktuara që mund të shqiptohen ndaj gjyqtarëve dhe procedurën ankimore, hetimore dhe disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Fjalët kyçe: llogaridhënia, përgjegjësia disiplinore, sanksionet disiplinore, ankesa, hetimi dhe procedura disiplinore.

1. Rëndësia e nxjerrjes së ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve

Aspekti i disiplinimit të gjyqtarëve është mjaft i rëndësishëm pasi që paraqet themel të pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe gjyqtarëve në veçanti. Disiplinimi i gjyqtarëve përmes parimeve të përcaktuara në ligj, krijon besueshmërinë e publikut në gjyqësor, po ashtu rrit transparencën dhe llogaridhënien e të cilat parime janë parakushte për një gjyqësor të pavarur dhe efikas në ushtrimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së

* Agim Maliqi është gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës.

¹ Më tutje do të referohemi me termin Ligj.

Kosovës, me Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor. Rregullimi i mirë i përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve është bazament për mbrojtjen e sistemit gjyqësor dhe garanton një punë profesionale të gjyqtarëve të cilëve u mundësohet që të nxjerrin vendime kualitative dhe brenda afateve të arsyeshme kohore.

E rëndësishme është të potencohet fakti se me ligjin e ri aspekti i disiplinimit të gjyqtarëve do të kaloj nëpër disa filtra dhe kjo do të jetë një garantues se do të zhvillohet një procedurë sipas standardeve që garantojnë efikasitet dhe transparencë të plotë ndaj publikut si gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore e po ashtu edhe për publikimin e vendimit përfundimtar për gjyqtarin të cilit i caktohet sanksioni disiplinor. Ligji, po ashtu ka përcaktuar një mekanizëm mjaft të rëndësishëm gjatë procedurës hetimore dhe gjithësesi i ka dhënë mundësi edhe gjyqtarit ndaj të cilit zhvillohet procedura të jetë pjesë aktive e procesit dhe të mund të paraqes të gjitha pretendimet e tij në fazën e hetimeve gjatë zhvillimit të procedurës dhe po ashtu edhe në fazën ankimore.

Në kapitullin e parë të ligjit janë përcaktuar qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit, përkufizimet dhe parimet e përgjegjësisë disiplinore. Me ligj janë përcaktuar shkeljet disiplinore, procedurat për fillimin e hetimeve në rastet kur ekzistojnë dyshimet për shkelje disiplinore, procedurat disiplinore që është përcaktuar se do të zhvillohen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, sanksionet disiplinore dhe mjetet juridike përkatësisht faza ankimore e cila është përcaktuar që të zhvillohet në Gjykatën Supreme të Kosovës. Parimet e përgjegjësisë disiplinore janë përcaktuar në mënyrë të qartë se zhvillimi i procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve si dhe shqiptimi i sanksioneve ndaj tyre ndërmerret në pajtim me këtë ligj dhe duke u bazuar në parimet e ligjshmërisë, respektimit të pavarësisë së gjyqësorit, gjykimit të drejtë, proporcionalitetit, transparencës, dhe llogaridhënies.²

Edhe pse këto parime përgjithësisht janë mjaft të njohura dhe të pranueshme, megjithatë në ligj nuk janë përkufizuar dhe qartësuar këto parime në të cilat do të udhëhiqet procedura disiplinore. Ashtu që në mungesë të përkufizimeve ligjore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me qëllim të zbatimit të ligjit në fjalë ka nxjerr Rregulloren për Procedurën Disiplinore (Rregullorja 05/2019)³ në të cilën ka përkufizuar parimet që do të zbatohen gjatë procedurës disiplinore, mirëpo me këtë rast nuk ka bërë përkufizimin e parimeve të definuara në ligj, dhe për më tepër, ka shtuar disa parime të tjera siç janë: parimi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare, parimi i mos diskriminimit të palëve, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i qasjes së barabartë.⁴ Konsiderojmë se parimet e theksuara në ligj do të duheshin të qartësoheshin edhe më tutje dhe njëkohësisht të shtoheshin edhe parime tjera me qëllim të pasurimit të parimeve që të mundësohej një bazë solide për procedurë disiplinore dhe për faktin se krijojnë siguri juridike të palëve në procedurë. Kurse parimet shtesë të përcaktuara në rregullore nuk do të duhej të përcaktoheshin pasi që

² Neni 3 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

³ Më tutje do ti referohemi me termin Rregullore.

⁴ Neni 3 i Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

është rregull që parimet të përcaktohen përmes ligjit dhe jo përmes legjislacionit sekondar, siç është vepruar.

2. Përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve

Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka përcaktuar se Gjyqtarët i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore për shkelje disiplinore në përputhje me procedurat e përcaktuara⁵. Kjo paraqet risi përkatësisht ndryshim substancial në krahasim me procedurën disiplinore që më parë ishte zhvilluar ndaj gjyqtarëve, pasi që përgjegjësia disiplinore dhe shkeljet disiplinore më parë ishin të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Këshillin Gjyqësor.⁶ Shkeljet disiplinore për gjyqtar janë kategorizuar në tri lloje të shkeljeve disiplinore dhe atë: nëse gjyqtari dënohet për një veprë penale (nënp.1.1), nëse shkel ligjin (nënp.1.2) dhe shkel detyrat e tij zyrtare (nënp.1.3).⁷

Shkelja disiplinore duke u bazuar në dispozitën e nenit 5 par.1 nënp.1.1 të Ligjit, kryhet automatikisht në rastet kur gjyqtari dënohet për një veprë penale. Mirëpo, konsiderojmë se dispozita në fjalë ka paqartësi dhe nuk është formuluar në mënyrë të duhur, për më tepër, mund të shkaktoj konfuzion në interpretim të saj. Sipas formulimit ligjor nuk është e qartë se cili është momenti kur konsiderohet se gjyqtari është dënuar për veprë penale e që logjikisht do të duhej të ishte momenti kur vendimi gjyqësor është i formës së prerë. Kjo paraqet paqartësi dhe pasiguri edhe për gjyqtarin edhe për të tjerët, meqë sipas kësaj potencialisht një gjyqtar mund të dënohet për një veprë të rëndë penale të natyrës korruptive nga gjykata e shkallës së parë, mirëpo nuk do të mund të konsiderohej se ka kryer shkelje disiplinore deri sa të vërtetohet me vendim të formës së prerë. Konsiderojmë se nuk do të duhet që secili dënim për veprë penale të konsiderohet automatikisht edhe shkelje disiplinore dhe potencialisht zhvillim të procedurës penale, meqë shpesh herë gjyqtari mund të kryejë vepra penale të ndryshme nga pakujdesia dhe me këtë rast praktikisht do të përfundonte karriera profesionale e një gjyqtari, pra do të duhej që të specifikohet se shkelje konsiderohen vetëm për rastet kur vepra penale kryhet me dashje.

Shkelja disiplinore e përcaktuar në dispozitën e nenit 5 par.1 nënp.1.2 të Ligjit, konsiderojmë se është mjaft gjithëpërfshirëse, e paqartë dhe me mundësi të interpretimit të gjerë, meqë shkelja e ligjit mund të jetë në forma dhe mënyra të ndryshme. Mënyra e formulimit mund të shkaktoj konfuzion të madh dhe po ashtu pasiguri juridike të gjyqtarëve dhe se si do të duket shkelja e ligjit në kuptim të kësaj dispozite ligjore. Duhet pasur parasysh faktin se shkelje e ligjit mund të bëhet edhe në rastet e kundërvajtjes në komunikacion dhe rrjedhimisht a duhet nënkuptuar se automatikisht në këto raste do të ketë bazë për fillimin e procedurës disiplinore, pasi

⁵ Neni 4 i Ligji nr.06/L-057për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

⁶ Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

⁷ Neni 5 i Ligji nr.06/L-057për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

që shkelja e ligjit mund të ketë kuptim të gjerë dhe interpretim që lehtësisht mund ti cenoj të drejtat e gjyqtarëve që janë subjekt i zhvillimit të procedurës.

Përkufizim dukshëm më i qartë është në nënparagrafin 1.3 të ligjit dhe qartësimi është bërë në paragrafin e dytë me ç'rast të gjitha shkeljet e detyrave të gjyqtarit janë përcaktuar në rast se vepron me dashje apo nga pakujdesia e rëndë.

Konsiderojmë se terminologjia e përdorur pakujdesia e rëndë është mjaft e gjerë dhe me këtë rast mund të cenoj rëndë të drejtat e gjyqtarëve që i nënshtrohen procedurave disiplinore me rastin e këtij interpretimi meqë nuk është përkufizuar qartë se çka konsiderohet pakujdesi e rëndë. Me siguri që ky aspekt do të shqyrtohet nga autoritetet që udhëheqin procedurën disiplinore, megjithatë, ky interpretim do të mund të cenonte barazinë e palëve në procedurë, pra më mirë do të ishte që të përkufizohej termi i përdorur “pakujdesi e rëndë” dhe kjo do të zgjidhte dilemën që mund të krijohet.

Shkeljet e përcaktuara në nenin 5 par.2 të Ligjit, përkufizojnë vetëm shkeljet e detyrave të punës së gjyqtarit kurse tërësisht është anashkaluar sjellja e tij jashtë funksionit gjyqësor përkatësisht gjatë jetës së tij private, edhe pse kjo është mjaft e rëndësishme dhe të cilat sjellje mund ta dëmtojnë reputacionin dhe besueshmërinë e publikut në gjyqësor. Megjithatë, përkundër kësaj tërthorazi është përcaktuar në rastet e sjelljes së gjyqtarit kur përfshihet në sjellje të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose e dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit edhe gjatë jetës private të gjyqtarit.⁸

Megjithëse, shkeljet e përcaktuara janë mjaft gjithëpërfshirëse konsiderojmë se patjetër shkelje do të duhej të përcaktohej edhe shkeljet të cilat janë të përcaktuara në Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar, pasi që me këtë rast do të ishte dukshëm më i pasur sfondi i shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve. Është e paqartë dhe mjaft diskutabile se pse nuk janë përfshirë shkeljet e sanksionuara në Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar, meqë sipas këtij interpretimi del se shkeljet etike tani kanë mbetur shkelje të cilat nuk sanksionohen dhe janë aspekt vullnetar i sjelljes së gjyqtarëve. Një argument tjetër i fuqishëm pro përfshirjes së kodit të etikës në kudër të shkeljeve disiplinore është edhe fakti se me ligjin e mëparshëm përkatësisht ishte përcaktuar si sjellje të pahijshme edhe shkelja e kodeve të zbatueshme të etikës.⁹Bazuar në hulumtimet e realizuara kemi vërejtur se shumica e shteteve të rajonit në shkelje disiplinore të veçantë kanë inkorporuar shkeljen e kodit përkatës së etikës.¹⁰

Në kontest të shkeljeve të theksuara, konsiderojmë se, shkeljet e përcaktuara në rastet kur gjyqtari keqpërdor pozitën zyrtare në çfarëdo forme për përfitime të paligjshme për veten ose personat e tjerë ose për qëllime tjera (nënpar.2.5) dhe rastet

⁸ Neni 5 i Ligji nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

⁹ Neni 34, Par.1, Nënpar. 1.4 i Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

¹⁰ Neni 90 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, Nr.20/2015.

kur gjyqtari ndërhyt në veprimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë me qëllim të ndikimit në aktivitetet dhe vendimet e tyre në çfarëdo mënyre të ndaluar me ligj (nënp.2.9), janë pa dyshim veprime që kapërcejnë kufirin e aspektit disiplinor dhe janë vepra penale, ashtu që nuk do të duhej të përfshiheshin në shkelje disiplinore.

2.1 Masat disiplinore

Për shkeljet disiplinore natyrshëm janë përcaktuar edhe sanksionet disiplinore që mund të shqiptohen ndaj gjyqtarëve dhe të cilat mund të shqiptohen një ose më shumë sanksione disiplinore që nënkupton se mund të shqiptohet edhe më tepër se një sanksion për një shkelje disiplinore. Sanksionet disiplinore që mund të shqiptohen ndaj gjyqtarëve janë pesë lloje të sanksioneve dhe atë: vërejtje jopublike me shkrim, vërejtje publike me shkrim, zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë përqind (50%) për një periudhë deri në një (1) vit, transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë tjetër të nivelit më të ulët dhe propozimi për shkarkim.¹¹

Me rastin e analizës së sanksioneve disiplinore vërejmë një dallim mes sanksioneve të parapara me ligjin në fuqi në krahasim me sanksionet e parapara në ligjin për KGJK, pasi që me ligjin e mëparshëm nuk ishte paraparë si sanksion disiplinor transferimi i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë më të ulët. Konsiderojmë se sanksioni disiplinor transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë tjetër të nivelit më të ulët e që është një sanksion i qëlluar në rastet kur një gjyqtar për shkak të shkeljeve disiplinore të mund të transferohet përkohësisht apo edhe përherë në ndonjë gjykatë tjetër më të ulët. Në kuadër të kësaj duhet theksuar se disa legjislacione kanë paraparë edhe masën tjetër që gjyqtarit ti pamundësohet avansimi në detyrë për disa vite varësisht prej shkeljes së bërë¹², meqë potencialisht gjyqtari i nivelit themelor nuk do të kishte mundësi shqiptimi i masave të transferimit në gjykatë më të ulët, andaj kjo masë do të ishte një mundësi e mirë e arritjes së efektit.

Po ashtu, konsiderojmë se sanksioni disiplinor vërejtja jopublike me shkrim është sanksion i cili do të jetë mjaft sfidues që të zbatohet dhe atë për disa arsye, së pari është e paqartë se si do të shqiptohet vërejtja jopublike me shkrim pasi që me vet shqiptimin e saj nuk do ta ketë efektin e duhur, dhe për më tepër, do të ketë jo transparencë pasi që ky sanksion nuk do të mund të publikohet sikurse vendimet e tjera disiplinore.¹³ Gjithsesi konsiderojmë se ky sanksion disiplinor është jashtë parimit të transparencës dhe llogaridhënies në të cilat parime mbështeten sanksionet disiplinore të përcaktuara sipas këtij ligji. Duhet potencuar edhe faktin tjetër se duke analizuar sanksionet që kanë përcaktuar ligjet e vendeve tjera të rajonit përkitazi me

¹¹ Neni 7, Par.1 i Ligjit Nr.06/L-057për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

¹² Neni 109 i Ligji Nr.11/2015 për Këshillin Gjyqësor të Malit të Zi.

¹³ Neni 7, Par.4 i Ligjit Nr.06/L-057për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

disiplinimin e gjyqtarëve, askund nuk kemi hasur se është paraparë një sanksion i tillë dhe me këtë është tejkalluar standardi i sanksioneve disiplinore.

Masat disiplinore është përcaktuar mund të shqiptohen sipas parimit të proporcionalitetit dhe me këtë rast duhet të merren parasysh disa faktorë të rëndësishëm duke filluar nga numri dhe serioziteti i shkeljeve, pasojat e shkeljes, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, performancën dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit dhe sjelljen e gjyqtarit dhe nivelin e bashkëpunimit gjatë procedurës disiplinore¹⁴ dhe pasi që të vlerësohen të gjithë këta faktor të potencuar më lartë të shqiptohet lloji dhe kohëzgjatja e masës përkatësisht sanksionit disiplinor. Kurse risi përkitazi me përgjegjësinë disiplinore është fakti se procedura mund të zhvillohet edhe pas përfundimit të detyrës së gjyqtarit dhe me këtë rast janë evituar pengesat që kanë qenë të vendosura sipas ligjit të mëparshëm se në rastet kur gjyqtari ka ofruar dorëheqje apo në ndonjë formë tjetër nuk ka qenë duke ushtruar funksionin e tij gjyqësor nuk është vazhduar procedura disiplinore përkatësisht është pezulluar pikërisht për shkak të mos ushtrimit të funksionit gjyqësor. Megjithatë mundësia e shqiptimit të sanksionit disiplinor sipas kësaj dispozite paraqet një situatë interesante dhe lë shumë pikëpyetje me faktin se shumica e këtyre sanksioneve që mund të shqiptohen janë jo efektive dhe të pazbatueshme ndaj gjyqtarëve që nuk ushtrojnë këtë funksion.

2.2 Ankesat dhe hetimet disiplinore

Në kapitullin e tretë të Ligjit është rregulluar aspekti i ankesave, hetimet dhe procedura disiplinore dhe me këtë rast mund të themi se në mënyrë strikte janë ndarë këto tri segmente të rëndësishme të procedurës disiplinore.

Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj gjyqtarit lidhur me pretendimet për shkelje disiplinore dhe me këtë rast i është dhënë mundësia që çdo person të mund të paraqes një pretendim, pra edhe personat juridik apo fizik që nuk kanë ndonjë interes përkitazi me pretendimet e ngritura. Është përcaktuar se ankesa mund të paraqitet tek kryetarët e gjykatave themelore dhe të apelit për gjyqtar të këtyre gjykatave dhe për kryetarët e gjykatave themelore dhe të apelit, autoritet kompetent për pranimin e ankesave është caktuar kryetari i gjykatës supreme, kurse për kryetarin e gjykatës supreme autoritet kompetent është vet Këshilli Gjyqësor, po ashtu ankesa mund të të ushtrohet edhe tek Avokati i popullit.

Është mjaft interesant fakti se sipas dispozitës ligjore në fjalë nuk është paraparë mundësia për ankesë ndaj gjyqtarëve të gjykatës supreme dhe me këtë rast në një formë gjyqtarët e kësaj gjykate janë amnistuar nga ushtrimi i ankesave ndaj tyre. Konsiderojmë se në këtë rast kemi të bëjmë me një lëshim të ligjvënësit pasi që patjetër duhet që edhe ndaj gjyqtarëve të gjykatës supreme të mund të ushtrohej ankesa për shkelje të pretenduara disiplinore.

¹⁴ Neni 7, Par.2 i Ligjit Nr.06/L-057për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Tutje është përcaktuar se ankesa duhet të bëhet në formë të shkruar dhe po ashtu duhet të përmbaj tri elemente të rëndësishme dhe atë: identitetin e personit fizik ose juridik i cili e paraqet ankesën, identitetin e gjyqtarit që do të jetë subjekt i hetimit dhe përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore.¹⁵

Autoriteti kompetent shqyrton ankesën e paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve nga data e pranimit të ankesës dhe kjo paraqet një afat të arsyeshëm kohor për të shqyrtuar dhe për të ndaluar apo vazhduar procedurën disiplinore. Në këtë fazë autoriteti kompetent do të luaj rolin e një filtruesi të ankesës dhe do të ketë mundësi që të procedoj më tutje në Këshillin Gjyqësor në rastet kur konsideron se duhet të fillohet procedura apo edhe të hudh ankesën në rastet kur gjen se: ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar.¹⁶ Edhe pse është përcaktuar se autoriteti kompetent e hudh ankesën, megjithatë duke i analizuar bazat rezulton se në disa raste ankesa do të duhej të refuzohet pasi që në rastin kur konsideron se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar dhe nuk ka të bëjë me shkelje disiplinore, patjetër se autoriteti kompetent do të lëshohet në meritat e çështjes me rastin e vendimmarrjes dhe jo thjeshtë vetëm të konstatoj një fakt, siç do të ishte afati i parashkrimit që në këtë rast nuk trajtohet fare përmbajtja e ankesës por llogaritet vetëm afati i parashkrimit.

2.3 Procedura hetimore

Faza më e rëndësishme e një procesi disiplinor pa dyshim se është procedura hetimore dhe kjo është faza në të cilën Këshilli Gjyqësor ka kompetenca mjaft të rëndësishme. Procedura disiplinore fillon nga ana e Këshillit dhe atë pas kërkesës së pranuar nga ana e autoritetit kompetent. Këshilli vihet në lëvizje përmes dy mekanizmave së pari pas vendimit të autoritetit kompetent duke u bazuar në vendimin e tij dhe përmes avokatit të popullit pasi që autoriteti kompetent ka bërë hudhjen e ankesës në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit, përkatësisht nëse konsideron se hudhja e ankesës nuk është e rregullt.

Edhe pse shprehimisht nuk është përcaktuar megjithatë autoriteti kompetent i paraqet kërkesë në formë të shkruar Këshillit dhe gjyqtarit që është subjekt i hetimit, për fillimin e hetimeve dhe me këtë rast Këshilli është filtri i dytë i shqyrtimit të kërkesës pasi që ka dy mundësi dhe atë në afat prej 15 ditëve nga pranimi i kërkesës e para që të formoj panelin hetues dhe mundësia e dytë është që të hudhë poshtë kërkesën pa formuar panelin hetues në rastet kur konsideron se kërkesa është prima facie, pa vlerë apo pa rëndësi serioze, jo substanciale, nuk ka lidhje me shkeljen disiplinore apo është parashkruar.¹⁷

¹⁵ Neni 9, Par. 4 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

¹⁶ Neni 9, Par. 6 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

¹⁷ Neni 12, Par. 5 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Paneli hetimor formohet nga tre gjyqtar të cilët nuk duhet të jenë nga gjykata ku punon gjyqtari që është subjekt i hetimit. Për dallim nga legjislacioni i mëparshëm kur hetimet inicioheshin nga zyra e prokurorit disiplinor, i cili përmes rekomandimit i drejtohej komisionit disiplinor të Këshillit Gjyqësor, tani sipas ligjit aktual përgjegjës për hetime përkatësisht për sigurimin e fakteve dhe mbledhjen e provave është paneli hetues. Autoriteti i cili ka kërkuar fillimin e procedurës dhe gjyqtari nën hetim kanë mundësinë e sugjerimit të dëshmitarëve dhe paraqitjen e provave si dhe të kërkojnë paraqitjen e dokumenteve dhe provave në dispozicion të personave apo institucioneve tjera. Paneli gjithashtu i ofron mundësinë gjyqtarit që të dëgjohej përkitazi me ankesën dhe për tu përfaqësuar nga avokati mbrojtës. Hetimet duhet të përfundojnë brenda periudhës prej tre muaj nga dita e themelimit të Panelit hetues.

Paneli hetues është e rëndësishme të theksohet se pas përfundimit të hetimeve përpilon raport me shkrim për të gjitha faktet dhe provat e mbledhura dhe të cilin raport e paraqet Këshillit, gjyqtarit që është nën hetim dhe autoritetit i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve disiplinore. Sipas dispozitave ligjore paneli hetues nuk ka kompetencë për të mbyllur rastin përkatësisht pushimin e procedurës hetimore, mirëpo gjithsesi raportin e tij duhet ta dërgoj në Këshill, megjithatë, konsiderojmë se paneli hetues duhet ta kishte rolin edhe të pushimit të procedurës disiplinore kur konstaton se nuk ka shkelje disiplinore. Është e rëndësishme të potencohet fakti se panelit i është dhënë mundësia që gjatë procedurës hetimore të ketë mundësi të lidhjes së marrëveshjes me subjektin që hetohet përkatësisht gjyqtarin, mirëpo nuk i është dhënë mundësia e përmbylljes së hetimit.

Përkitazi me marrëveshjen vullnetare në praktikë mund të paraqiten paqartësi meqë nuk është specifikuar mjaftueshëm se marrëveshja e lidhur mes të panelit hetues dhe gjyqtarit a duhet të dërgohet në Këshill për tu aprovuar apo jo. Kjo dykuptimësi është krijuar për faktin se neni 13 par.3 i Ligjit thekson se marrëveshja e miratuar nga paneli hetimore do të ketë efektin ligjor sikurse vendimi i Këshillit, megjithatë neni 14 par.1 i Ligjit thekson se pas pranimit të marrëveshjes këshilli do të mbaj seancë. Kjo paraqet kolizion mes këtyre dy dispozitave ligjore dhe mund të shkakton konfuzion në zbatimin në praktikë të dispozitave të sipërtheksuara, konsiderojmë se do të duhej të qartësohej po ashtu situata se me arritjen e marrëveshjes me panelit hetimor dhe gjyqtarit çfarë do të ndodhte nëse këshilli nuk do ta pranonte këtë marrëveshje dhe si do të procedohej më tutje.

Gjithashtu nuk është specifikuar se çka do të përmbaj raporti i panelit, se a mundet të propozohet masa konkrete për gjyqtarin apo do të jetë vetëm një panel që do të mbledh prova dhe fakte pa ndonjë konkludim përkitazi me epilogun e rastit. Nga kjo arsye në praktikë ka pasur dilema dhe mes vet rasteve që paneli hetimor i ka hetuar, megjithatë, konsiderojmë se bazuar në vet emërtimin panel hetimor duhet nënkuptuar se do të duhej të zhvillonte hetime dhe si rezultat i hetimeve të vendoste përkitazi me faktin se a ka gjetur apo jo shkelje disiplinore dhe eventualisht propozimin e masës disiplinore. Por për tu eliminuar këto dilema duhet që të

ndryshohet ligji dhe panelit hetimor i përcaktoheshin kompetenca të qarta përkitazi me shtrirjen e kompetencave të tij.

3. Procedura disiplinore

Kompetente për mbajtjen e seancës dëgjimore pas pranimit të raportit është Këshilli dhe atë brenda periudhës prej 30 ditësh pas pranimit të raportit, mirëpo në rastet më komplekse mund të mbajë edhe seanca shtesë. Palët do të ftohen të marrin pjesë në procedurë, mirëpo përveç gjyqtarit që është e qartë se e ka rolin e palës në procedurë, megjithatë nuk është e qartë se kush është pala tjetër në procedurë dhe atë a është paraqitësi i ankesës, autoriteti kompetent që ka iniciuar procedurën apo paneli hetues. Kjo lë mjaft hapësirë të gjerë për interpretim të palës tjetër në procedurë dhe kjo paqartësi thellohet duke u bazuar në faktin e theksuar se paneli hetimor pushon funksionin e vet në momentin kur rasti bëhet i formës së prerë.¹⁸ Vakumi ligjor për të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë palën tjetër në procedurë (meqë për gjyqtarin ndaj të cilit zhvillohet procedura nuk ka dilemë) është munduar që të mbulohet me rregulloren për procedurën disiplinore të gjyqtarëve ku janë përcaktuar se palë në procedurë disiplinore është subjekti i hetimit dhe në vartësi të rrjedhës së procedurës disiplinore palë janë parashtruesi i ankesës, kryetari i gjykatës, këshilli dhe avokati i popullit.¹⁹

Kuorumi për zhvillimin e procedurës disiplinore përbëhet nga nëntë anëtar të Këshillit, kurse vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm dhe vendosë nëse është kryer shkelja disiplinore dhe nëse konstaton se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore shqipton sanksionin disiplinor.

Vendimi i Këshillit duhet të merret brenda dy muajve nga pranimi i raporti nga paneli hetues, kurse vendimi përpilohet në formë të shkruar dhe të përmbajë arsyet mbi vendimin dhe këshillën juridike dhe kopjet e vendimit u dërgohen autoritetit kompetent që ka kërkuar fillimin e hetimeve dhe gjyqtarit ose prokurorit, dhe në rastet e parapara me nenin 12 par.3 të këtij ligji Avokatit të Popullit.

Duke u bazuar në zhvillimin e procedurave disiplinore të përcaktuara sipas ligjeve të vendeve tjera të rajonit që e rregullojnë këtë sferë, është evidente se kjo mënyrë e vendosjes që procedurat disiplinore në shkallë të parë shqyrtohen nga ana e këshillave përkatëse aplikohet vetëm në Republikën e Kroacisë.²⁰ Kurse shtetet tjera kanë zgjidhje tjera dhe atë: në Slloveni, procedura disiplinore zhvillohet në shkallën e parë nga ana e tre gjyqtarëve të cilët paraprakisht emërohen në përbërje prej tetë gjyqtarëve të të gjitha nivelit të gjyqësorit, të cilët emërohen në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme me propozim të Këshillit gjyqësor me mandat dy

¹⁸ Neni 9, Par. 8 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

¹⁹ Neni 2 Par. 1.5 i Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

²⁰ Neni 79 i Ligji Nr.82/2015 për Këshillin Gjyqësor të Kroacisë.

vjeçar, kurse në shkallë të dytë përbërja është po ashtu nga tre gjyqtarë të cilët emërohen sikurse gjyqtarët që vendosin në shkallën e parë.²¹ Në Republikën e Maqedonisë procedura disiplinore në shkallën e parë zhvillohet nga një komision prej tre anëtarëve të cilët zgjidhen me mandat tre vjeçar nga ana e këshillit gjyqësor, kurse si organ i shkallës së dytë vendosë vet këshilli gjyqësor.²² Konsiderojmë se kjo zgjidhje ligjore që këshilli të vendosë si shkallë e parë në procedurë disiplinore gjithsesi do të jetë mjaft sfiduese, së pari në arritjen e kuorumit siç kërkohet për arsye të mundësisë së përjashtimit të anëtarëve nga vendimmarrja apo edhe aspekte tjera dhe po ashtu mund të paraqiten probleme përkitazi me arritjen e shumicës së thjeshtë të votave me rastin e vendosjes.

3.1. Ankesa ndaj vendimeve disiplinore

Ankesa ndaj vendimeve disiplinore gjithsesi është një ndër fazat më të rëndësishme të procedurës dhe fillimisht është përcaktuar se përkitazi me ankesë është përcaktuar se kompetencë ekskluzive për të shqyrtuar ankesat është Gjykata Supreme e Kosovës dhe atë brenda afatit prej 15 ditëve nga pranimi i ankesës.²³

Ankesa është paraparë që të ketë karakter suspenziv, kurse janë përcaktuar tri baza për paraqitjen e saj dhe atë në rast të zbatimit të gabuar të ligjit, në rast të shkeljes procedurale të përcaktuara me ligj dhe në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës.

Është përcaktuar se kryetari i Gjykatës Supreme është i autorizuar që të zgjedh anëtarët e trupit gjykues nga gjyqtar të gjykatës supreme, kurse përjashtimisht në rastet kur subjekt i procedurës ankimore është kryetari i Gjykatës Supreme, atëherë përzgjedhja bëhet nga ana e gjyqtarit më të moshuar të asaj gjykate.

Gjykata Supreme me rastin e shqyrtimit të ankesës, mund ta konfirmoj vendimin e Këshillit Gjyqësor, ta ndryshoj apo ta kthej në rishqyrtim rastin në Këshill, kurse në rastet kur rasti kthehet në rishqyrtim, Këshilli vendos brenda afatit prej 30 ditëve dhe në formë të shkruar e njofton Gjykatën, kurse në raste kur gjykata Supreme nuk merr njoftim nga Këshilli në afatin e përcaktuar, atëherë brenda afatit prej 15 ditëve vendos rastin dhe i cili vendim është përfundimtar.

Në këtë pjesë ligji ka lënë disa dilema përkitazi me të drejtën e ankesës, së pari është theksuar se ankesë kanë të drejtë të ushtrojnë palët, kurse nuk është përcaktuar se cilat janë palët në procedurë edhe pse njëra palë është e ditur se është gjyqtari ndaj të cilit është udhëhequr procedura dhe në raste të caktuara kur rasti inicohet nga ana e Avokatit të Popullit edhe ky institucion ka të drejtën e ushtrimit të ankesës. Mirëpo e paqartë ka mbetur se paneli hetues a ka të drejtë të ushtroj ankesë në rastet

²¹ Neni 86 dhe 87 i Ligjit Nr.94/07për Këshillin Gjyqësor të Sllovenisë.

²² Nenet 24-31 të Ligjit Nr.20/2015 për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

²³ Neni 15, Par.1 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

kur Këshilli e liron nga procedura disiplinore gjyqtarin, paqartësinë e bën edhe më të madhe pasi që me Ligj nuk është përcaktuar se cilët janë palët në procedurë disiplinore.

Është e paqartë se pse ka mbetur që Gjykata Supreme të vendosë përkitazi me ankesat e paraqitura përkatësisht ta ketë rolin e organit të shkallës së dytë, duke marrë parasysh se procedura disiplinore përfundon me një vendim administrativ, konsiderojmë se do të ishte e justifikueshme që të ndiqej procedura administrative sipas hierarkisë gjyqësore meqë përfundimisht vendimi final do të merrej nga ana e Gjykatës Supreme me mjete të jashtëzakonshme juridike

4. Përfundim

Në përfundim të këtij punimit është e rëndësishme të theksohet se përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve është një ndër sferat më të rëndësishme për një gjyqësor të pavarur, ashtu që përmes procedurave të përcaktuara ligjore sigurohet llogaridhënia e gjyqtarëve. Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve, në fokus ka zhvillimin e proceduarve standarde duke mos cenuar në asnjë moment pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore.

Natyrshëm duke marrë parasysh se me Ligjin e ri ka ndryshime substanciale në krahasim me ligjin e mëparshëm përkitazi me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve mund të paraqiten edhe probleme të natyrave të ndryshme në implementimin e këtij ligji, megjithatë si tërësi ligji besojmë se do të përmbushë në tërësi synimet për një gjyqësor të pavarur, transparent dhe llogaridhënës.

Disiplinimi i gjyqtarëve tani më ka kaluar në dimension tërësisht të ri dhe bartëse e procesit disiplinor përkatësisht hetimeve dhe procedurës disiplinore do të jenë vet gjyqtarët përmes paneleve hetuese dhe që garanton se do të kemi procedura më profesionale se sa deri më tani janë zhvilluar. Po ashtu vlen të theksohet fakti se Ligji ka përcaktuar disa mundësi të filtrimit të ankesës dhe hudhjes së saj për të mos u zhvilluar proceduar disiplinore në rastet kur veprimi i gjyqtarit nuk konsiderohet shkelje disiplinore dhe thellësisht besojmë se këto mekanizma do të jenë funksional me qëllim që ankesat e shumta që bëhen ndaj gjyqtarëve për shkak të natyrës së punës së tyre të mos vazhdojnë deri në statet e avancuara të procedurës por të ndalen në statet e hershme të saj.